

RELACION

PËR PROJEKT VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE 2023-2027”

I.QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti për miratimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2023-2027 propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si një dokument politik i qeverisë shqiptare. Ky dokument strategjik, në mënyrë ndërsektoriale përmban objektiva dhe masa për përfshirjen sociale në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 dhe në përputhje me Parimet e Shtyllës Europiane për të Drejtat Sociale dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Axhendës 2030 të OKB.

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) 2023-2027 është hartuar me qëllim matjen dhe monitorimin e politikave dhe rezultateve të objektivave ndërsektoriale për përfshirjen sociale me fokus përfshirjen dhe integrimin në shoqëri të kategorive të veçanta.

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2023-2027 është një dokument vijues që hartohet bazuar në raportin e monitorimit 4-vjeçar për periudhën 2016-2020, raportime vjetore dhe afatmesme të dokumentave ndërsektoralë për grupe të veçanta të cilat përmbajnë tregues, të dhëna statistikore dhe analiza për përfshirjen në shoqëri të grupeve në nevojë.

Vizioni i Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale (DPPS) është të garantojë një sistem transparent dhe efektiv për vlerësimin e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave që lidhen me reduktimin e varfërisë dhe mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë, shëndetin, arsimin, strehimin, plotësimin e nevojave bazë si dhe realizimin e të drejtave të njeriut.

Objektivi i përgjithshëm i Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale është të krijojë një kuadër të balancuar dhe të qëndrueshëm për të siguruar matjen, monitorimin dhe raportimin e përfshirjes sociale në Shqipëri përmes një grupi treguesish të konsoliduar, duke përmirësuar lidhjet midis përfshirjes sociale dhe përmirësimit të politikave të qeverisë gjatë progresit të vendit drejt anëtarësimit në BE.

Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet një kuadri të përgjithshëm të përfshirjes sociale i parashtruar në këtë dokument të politikave, që bazohet në tregues nga gjashtë fusha, për të garantuar monitorim cilësor dhe sasior të përfshirjes sociale, krijimin e kapaciteteve teknike dhe administrative për të rritur efikasitetin në mbledhjen e të dhënave, ndërgjegjësimin për përfshirje sociale dhe kohezionin social në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE.

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale do t'i mundësojë gjithë institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, partnerëve strategjikë një instrument që do të garantojë

mbledhjen, përpunimin dhe monitorimin e të dhënave sipas gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe variablave të tjerë kyçë për përfshirjen dhe kohezionin social.

DPPS lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 dhe me strategji të tjera ndërsektorale dhe plane veprimi si:

- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020-2023);
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2025);
- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (2021-2025)
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030);
- Strategjia Kombëtare e Strehimit Social (2016-2025);
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë (2021-2030)
- Plani Kombëtar i Veprimit për Promovimin e Shëndetit (2021-2030);
- Strategjia Kombëtare e Arsimit (2021-2026);
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (2023-2030)
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021-2026) dhe
- Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI (2021-2027)

Nënobjektivat kryesore strategjike me objektivat e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale janë:

i. Të identifikojë dhe trajtojë sfidat me të cilat përballet monitorimi dhe matja e përfshirjes sociale duke përmirësuar treguesit e BE-së dhe ata kombëtarë që janë të nevojshëm për të mbështetur reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e masave efikase që rrisin mirëqenien.

ii. Të nxisë koherencën e politikave, të vendosë përparësitë dhe të përcaktojë përgjegjësitë për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale.

iii. Të rrisë transparencën e ndikimit që kanë pasur politikatat e ndjekura, si dhe të rrisë transparencën e përpjekjeve të bëra nga qeveria për forcimin e politikave që ndikojnë mbi përfshirjen sociale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Dokumentit i Politikave të Përfshirjes Sociale, si një dokument strategjik që parashikon politikatat për përfshirjen sociale është në harmoni dhe në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE III) 2022-2030. DPPS është në linjë me parashikimet e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2021-2023, kapitulli 19, “Punësimi dhe Politikatat Sociale” dhe lidhet me Kapitullin 23 (Të drejtat themelore), Kapitullin 26 (Arsimi dhe Kultura) dhe Kapitullin 28 (Shëndetësia).

Ky projektakt nuk është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2026.

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2023-2027”

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Aktualisht sistemet e mbledhjes së të dhënave që funksionojnë për monitorimin e përfshirjes sociale kanë mungesa në matjen e të gjitha dimensioneve të përjashtimit social, frekuencës dhe analizës.

DPPS synon të rrisë bashkërendimin e punës së insitucioneve të ndryshme, të reduktojë fragmentimin në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për përfshirjen sociale dhe varfërinë. Këto të dhëna duhet të paraqesin një panoramë sistematike dhe transparente të situatës aktuale në Shqipëri dhe duhet të shërbejnë si bazë për politika bazuar në të dhëna.

DPPS është një domosdoshmëri për ngritjen dhe konsolidimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi; harmonizimin e kornizave ligjore dhe prioritetëve strategjike në fushat përkatëse të përfshirjes sociale dhe zhvillimin e ndërhyrjeve të ardhshme për reduktimin e përjashtimit social dhe fuqizimin e grupeve në nevojë në të gjitha aspektet e gjithëpërfshirjes.

Bashkërendimi inistitucional dhe kuadri i të dhënave dhe treguesve që përmban DPPS është parakusht për krijimin e një sistemi monitorimi për përfshirjen sociale në Republikën e Shqipërisë dhe për harmonizimin e tij me atë të shteteve anëtare të BE-së.

DPPS është vazhdim i angazhimit të Qeverisë Shqiptare për monitorim dhe transparencë dhe përmban tre shtylla kryesore:

1. Shtylla A: Sisteme të qëndrueshme për përfshirjen sociale
2. Shtylla B: Menaxhimi i përfshirjes sociale dhe dialogut mbi politikat
3. Shtylla C: Përmirësimi i dialogut mbi politikat

DPPS fokusohet në çështje që nevojitet të maten dhe monitorohen në përputhje me standardet statistikore të krijuara në nivelin e Bashkimit Evropian në gjashtë fusha: (1) ulja e varfërisë dhe mbrojtja sociale; (2) punësimi dhe aftësitë; (3) arsimiti dhe formimi; (4) shëndeti; (5) nevojat bazë; dhe (6) të drejtat e njeriut. Përkatësisht, përmirësimi i shkëmbimit dhe ndërveprimit, si dhe cilësia e të dhënave në këto fusha të përfshirjes, për një bashkërendim dhe koordinimin e punës drejt monitorimit me instrumenta bashkëkohorë.

Përsa më sipër të dhënat administrative në gjashtë fushat e politikave dhe anketat ekzistuese do të jenë thelbësore për të hartuar politika të përditësuara, metodologjitë e përfshirjes sociale, si dhe integrimin e metodologjive për të garantuar integrimin e variablave kyç si gjinia, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, vendndodhja, lloji i vendbanimit etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMIT ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar. Dokumenti është hartuar në harmoni me Objektivat Socialë, Neni 59 i Kushtetutës dhe me instrumentet ndërkombëtarë të mëposhtëm:

-Mekanizmi UPR nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut është procesi për raportimin për të drejtat e Njeriut në vendet anëtare të OKB-së dhe detyrimin e shteteve palë për raportim

- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore OKB
- Pakti Social për të Drejtat Civile dhe Politike
- Karta Sociale Europiane e rishikuar

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Republika e Shqipërisë është angazhuar në plotësimin e detyrimeve të BE-së në vijim të Samitit të Lisbonës dhe të Kopenhagenit dhe Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, që adreson rritjen e qëndrueshme dhe rëndësinë e përfshirjes së grupeve në nevojë në të gjitha fushat duke mënjanuar pabarazitë për grupe të veçanta.

Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale nuk përafron direktiva të BE-së, por është në linjë me Dokumentin e BE-së "Drejt një Europe të Qëndrueshme 2030", Shtyllën Sociale të të Drejtave të BE si dhe ka ndërveprim me Kuadrin e të drejtave dhe dokumentat strategjikë të BE për romët, Personat me Aftësi të Kufizuar dhe grupet në nevojë.

Gjithashtu dokumenti adreson rekomandimet e Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, ku theksohet që Shqipëria duhet të forcojë përpjekjet për përmirësimin e politikëbërjes bazuar në të dhëna, duke rritur kapacitetet administrative të ministrive të linjës në planifikimin e politikave.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Dokumenti përmban disa qëllime politike, të cilat synojnë monitorimin dhe zhvillimin e politikave dhe bashkërendimin për sisteme të integruara, gjithëpërfshirëse për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale nëpërmjet përdorimit të treguesve në nivel kombëtar për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale. Krahas treguesve administrative, do të përdoren dhe anketat, që matin treguesit social si dhe statistika të tjera për vlerësimin e rezultateve të politikave.

Qasja e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale (2023-2027) është e harmonizuar me qasjen e objektivave kryesorë të Qeverisë për politikën sociale gjithëpërfshirëse. Njëkohësisht, koordinimi me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (ASHPSKN) do të mundësojë harmonizimin me objektiva dhe nënobjektiva të tjerë të SKZHIE.

Qeveria e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë kanë prezantuar tashmë Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), e cila mundëson përparimin e sistemit të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për situatën e grupeve dhe individëve të ndryshëm, që vuajnë nga përjashtimi social dhe fillimin e procesit të harmonizimit të monitorimit të treguesve të përfshirjes sociale me vendet e BE-së.

Sistemi i monitorimit të përfshirjes sociale duhet të përfshijë aspekte të ndryshme të ndarjes së të dhënave, sepse llojet dhe intensiteti i përjashtimit janë të shpërndara në mënyrë shumë të pabarabartë në kategori të ndryshme sociale. Në këtë mënyrë, do të jenë efektive dhe ndërhyrjet dhe politikat në përputhje me karakteristikat e grupeve në nevojë.

Vizioni i një sistemi modern dhe efikas për matjen dhe monitorimin e përfshirjes sociale në Shqipëri do të arrihet përmes zbatimit të disa instrumenteve sic janë Grupi i Statistikave të

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2023-2027"

Përfshirjes Sociale dhe Ekipi Burimor Teknik pranë MSHMS, që do të koordinojnë aktivitetet e Dokumentit të Politikave për Përfshirjen Sociale. Këto procese do të zhvillohen në koordinim me të gjitha ministrinë, institucionet në nivel qendror e vendor, institucionet e pavarura, institucionet e qeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit si dhe në bashkëpunim me partnerët strategjikë.

Aktivitetet e parashikuara në DPPS përqendrohen në:

- Forcimin e kapaciteteve në nivelin e qeverisjes qendrore për të bashkërenduar, monitoruar dhe ofruar udhëzime rreth përfshirjes sociale.
- Rritjen e kapaciteteve të ministrive të linjës për të hartuar, planifikuar dhe zbatuar politikatat e përfshirjes sociale si pjesë e veprimtarive të tyre periodike.
- Përmirësimin e sistemit statistikor të Shqipërisë për monitorimin e treguesve të përfshirjes sociale.
- Përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare në nivel qendror dhe vendor në planifikimin dhe zbatimin e politikave të përfshirjes sociale, në përputhje me parimin e subsidiaritetit.
- Ofrimin e mbështetjes për pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në bashkëpunime rajonale, si dhe për të garantuar se përpjekjet e vendit në fushën e përfshirjes sociale njihen dhe mbështeten nga Komisioni Europian.

Rezultatet e pritshme nga Strukturës Burimore Teknike (SBT) janë:

- Zhvillimi, miratimi dhe përfshirja e politikave të përfshirjes sociale në strategjitë sektoriale dhe kuadrot ligjorë/strategjitë e politikave kombëtare brenda vitit 2027.
- Harmonizimi/integrimi i raportimit për përfshirjen sociale në raportimin e rregullt të Qeverisë, në kuadër të dialogut të politikave të saj me BE-në mbi përparimin e bërë në përfshirjen sociale.
- Ulja e varfërisë dhe marginalizimit përmes shtimit të njohurive mbi llojet, shkaqet dhe intensitetin e përfshirjes sociale.

Grupi i Statistikave të Përfshirjes Sociale përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet kryesore qeveritare përgjegjëse për mbrojtjen sociale, punësimin dhe zhvillimin e sipërmarrjes, shëndetin, arsimin, strehimin, drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, struktura përgjegjëse në MSHMS asistohet nga Ekipi Burimor Teknik.

Në nivel qendror, udhëhiqet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Institutin e Statistikave dhe përfaqësues të institucioneve të tjera përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e treguesve të performances sipas baseline.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti sipas fushave të politikave ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Projektvendimi është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhër Nr. 112 Datë 14.02.2022 "Për hartimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale" të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Grupi i Punës u konsultua me përfaqësues nga institucionet përgjegjëse si Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, INSTAT dhe institucione të varësisë të MSHMS, të cilat kanë kontribuar me të dhënat dhe treguesit, që duhet të monitorohen sipas fushave dhe aktivitetet kryesore për përmirësimin e treguesve të impaktit të politikave. Me mbështetjen dhe ekspertizën e PNUD përmes ekspertëve, të cilët lehtësuan punën e GNP në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik.

Projektakti dërgohet për mendim pranë: Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) Kryeministri, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Shtetit për Fëmijën dhe të Rinjtë, Institutit të Statistikave (INSTAT), Komisionerit Kundër Diskriminimit, Avokatit të Popullit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin Euro 2,041,000 Euro të parashikuara në 5 vite si kosto administrative të ndara në tre shtylla me masa dhe aktivitete për secilën si më poshtë:

- Shtylla A - Sistemet e qëndrueshme për përfshirjen sociale - Euro 1 246 000
- Shtylla B- Sistemet efektive për menaxhimin e përfshirjes sociale Euro 385 000
- Shtylla C- Përmirësimi i dialogut mbi politikat Euro 41000

Dokumenti do të rishikohet sipas ciklit të PBA në përputhje me progresin në zbatimin e masave. Për masat e Dokumentit, që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

PROPOZUESI

ALBANA KOÇI

MINISTRE

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për hartimin e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2023-2027"